

AKT THEMELIMI

i Shoqerise Tregtare Me Pergjegjesi Te Kufizuar

Shoqeria "Lyerje 'Black Carbon' " SHPK

Themeluesi qe firmosi me poshte :

DANJEL PISHA – atesia Xheladin amesia Tefta datelindjes 29.10.1998 lindur ne Elbasan dhe banues ne Elbasan i pajisur me pasaporten biometrike me nr. Personal J81029064I

ANTONIO CASARI – atesia Amerigo amesia Pasqualina i datelindjes 18.08.1979 lindur ne San Giovanni in Persiceto (BO) dhe banues ne Calderara Di Reno (BO) Prati n.31 i pajisur me karte identiteti italiane me nr. AU8692134.

ANDREA DALL'OMO – atesia x amesia Pia i datelindjes 29.04.1956 lindur ne Bologna (BO) dhe banues ne Bologna i pajisur me pasaporte italiane me nr. YA8767485.

Qe ne vijim do te perbeje **Asamblene e Pergjithshme te Shoqerise.**

Sot me date **24.01.2022** bazuar ne vullnetin e tyre te lire dhe ne perputhje me ligjin nr.9901 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", vendosen te themelojne Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar, ne baze te kushteve qe vijojne:

KREU I

OBJEKTI, EMERTIMI, SELIA, REGJIMI JURIDIK

Neni 1

Objekti i Shoqerise

Lyerje automjetesh, Kruajtje, Shkelqim, Montim, Riparim Plastike/ Xhami/ Metali. Printim/ Stampim Fibra Karboni.

Neni 2

Emertimi dhe Selia Juridike e Shoqerise

Ortaket themelues vendosen qe shoqerine ta emertoje "Lyerje 'Black Carbon' " SHPK

Selia e shoqerise eshte : : Labinot Fushe – Elbasan Pasuria "B" Zona Kadastrale 2355.


Shoqeria mund te krijoje dege, zyra perfaqesimi e filiale brenda territorit te Republikes se Shqiperise.

Neni 3

Regjimi Juridik

1- Shoqeria eshte shoqeri me pergjegjesi te kufizuar. Veprimtaria e saj i nenshtrohet dispozitave te Aktit te Themelimit, Statutit dhe legjislacionit ne fuqi ne Shqiperi.

2- Shoqeria gezon personalitet juridik nga data e rregjistrimit te saj ne rregjistrin tregtar nga organet kompetente dhe ne perputhje me ligjin.



3- Shoqeria do te kete vulen e saj.

KREU II

TE DREJTAT DHE DETYRAT, KOHEZGJATJA

Neni 4

Te drejtat e Shoqerise dhe te Ortakut.

1. Shoqeria ka te drejte te lidhe marreveshje dhe te nenshkruaje kontrata vetem ne territorin e Shqiperise.
2. Shoqeria gezon te drejten te krijojte pasuri materiale dhe intelektuale.
3. Shoqeria ka te drejte te marre pjese si ortak ne shoqeri ose ne ndermarrje te ndryshme ne Shqiperi, ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.
4. Shoqeria pergjigjet ndaj te treteve vetem dhe ekskluzivisht me kapitalin e saj themeltar dhe me te mirat e pasurise se saj.
5. Ortaket marrin pjese ne administrimin e veprimtarise se shoqerise ne perputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin, vete ose nepermjet perfaqesuesve te tyre.
6. Ortaket kane te drejte te marrin te gjitha informatat qe kane te bejne me veprimtarine prodhuese, projektuese, realizuese e tregtare te shoqerise, si bilancet, llogarite ekonomike etj.

Neni 5

KOHEZGJATJA

Kohezgjatja e shoqerise eshte me afat 5 vjecar duke filluar nga data 24.01.2022 deri me date 23.01.2027 me te drejte riperteritje.

KREU III

KAPITALI THEMELTAR, KUOTAT

Neni 6

Vlera e kapitalit themeltar te nenshkruar

Kapitali themeltar i nenshkruar i shoqerise ka nje vlere prej 100 Leke (njqind) leke.

Neni 7


Numri i pjeseve te kapitalit themeltar te nenshkruar

Numri i pjeseve te kapitalit themeltar te nenshkruar eshte 3 (tre) kuota.

Neni 8

Vlera nominale e seciles pjese te kapitalit themeltar te nenshkruar

Vlera nominale e seciles pjese te kapitalit themeltar te nenshkruar eshte 100 leke.



Neni 9

Pjesemarrja ne kapitalin themeltar te nenshkruar

Pjesemarrja ne kapitalin themeltar te nenshkruar eshte :

DANJEL PISHA – i cili zoteron 33 % te kuotave te shoqerise.

ANTONIO CASARI – i cili zoteron 34 % te kuotave te shoqerise.

ANDREA DALL'OMO – i cili zoteron 33 % te kuotave te shoqerise.

KREU IV

ORGANET E SHOQERISE

Neni 10

Vendimet ne shoqeri merren nga Asambleja e Pergjithshme. Keto vendime shenohen ne Librin e Shoqerise. Administratori i Shoqerise, eksperti kontabel i autorizuar dhe drejtuesi teknik caktohen nga Asambleja e Pergjithshme.

KREU V

ADMINISTRIMI

Neni 11

Administrimi i Shoqerise do te behet ne perputhje me Statutin qe i bashkangjitet ketij Akti.

KREU VI

DISPOZITA TE TJERA

Neni 12

Fitimi i realizuar nga Shoqeria, pas shlyerjes se detyrimeve ligjore, do t'i ndahet Ortakut te shoqerise sipas pjeseve kontribuese ne kapitalin themeltar. Ky akt shtypet dhe firmoset ne kater kopje, te gjitha me te njejten vlere ligjore. Nje kopje qendron ne dokumentacionin baze te Shoqerise.

ORTAKET THEMELUES te Shoqerise "Lyerje 'Black Carbon' " SHPK

DANJEL
PISHA


DALL'OMO ANDREA CASARI Antonio
